



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 10 prill 2018**

**Numri i lëndës: 2017-01**

**A.Z.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 prill 2018, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Z. Jorge MARTINS RIBEIRO, anëtar zëvendësues

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në Panel më 13 mars 2017.
2. Paneli ka miratuar kërkesën e parashtruesit të ankesës që emri i tij/saj mos të zbulohet. Parashtruesi i ankesës do të përmendet si A.Z.
3. Znj. Bednarek është tërhequr nga kjo lëndë, për shkak të paraqitjes së konfliktit të interesit dhe nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e lëndës, në përputhje me Rregullën 12(1) (1) të Rregullores së Punës së Panelit. Ajo është zëvendësuar nga z. Jorge Martins Ribeiro, anëtar zëvendësues i Panelit.

## II. FAKTET

4. Faktet e rastit, të parashtruara nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
5. Ankuesi pohon se ajo është përndjekur dhe torturuar në punë nga persona që kanë të bëjnë dhe janë të mbrojtur nga partia politike PDK. Ajo më tej pohon se ka qenë viktimë e abuzimit psikologjik në familje, të kryer nga nëna e saj. Ajo është ankuar për këto çështje në disa institucione vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës dhe OSBE-në.
6. Më 15 dhe 16 prill 2014, ankuesi ka ngritur pretendimin e saj kundër kolegëve të saj të punës dhe nënës së saj në një letër në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK).
7. Më 2 qershor 2014, ushtruesi i detyrës së zëvendës kryeprokurorit të EULEX-it ka informuar ankuesin se PSRK-ja kishte shqyrtuar me kujdes dokumentet e saj. Megjithatë, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, asaj iu është thënë se nuk kishte bazë për PSRK-në që të ushtronte kompetencën e vet në këtë rast të veçantë. Ai e ka këshilluar ankuesin që t'i drejtojë pretendimet e saj Prokurorisë Themelore në Prizren. Ai gjithashtu ka rekomanduar që ankuesi të kërkojë këshilla ligjore nga një avokat privat i kualifikuar dhe i ka ofruar ankuesit të dhëna kontakti të Zyrës për Ndhimë Ligjore, e cila ofron ndihmë juridike.
8. Më 9 janar 2015, ankuesi i ka dërguar një letër zyrës së kryeprokurorit të EULEX-it. Më 15 janar 2015, ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it është përgjigjur se parashtrësit e saj ishin shqyrtuar me kujdes, por në bazë të Ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi Kompetencat) kërkesa e saj nuk ka hyrë në kuadër të kompetencave të prokurorëve të EULEX-it dhe se nuk do të ndërmerreshin hapa të mëtejshëm. Përveç kësaj, ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit ka këshilluar ankuesin që ajo të parashtrrojë ankesë pranë autoriteteve kompetente vendore.
9. Më 26 janar 2015, zyra e kryeprokurorit të EULEX-it ka marrë një ankesë të ngjashme nga ankuesi. Në përgjigjen e tij të datës 27 janar 2015, ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit ka përsëritur atë që kishte thënë në letrën e tij të datës 15 janar.

## III. LIGJI I ZBATUESHËM PËRKATËS

*Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it*

**Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it**

- 7.1 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetenca dhe përgjegjësi që të ushtrjnë funksionet e tyre, përfshirë këtu kompetencat për të kryer hetime penale siç përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.
- 7.2 Prokurorët e EULEX-it do të kenë kompetencë për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet që hyjnë brenda kompetencave të PSRK-së në përputhje me ligjin mbi PSRK-në.

*Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (Ligji mbi PSRK-në)*

**Neni 5 Kompetenca e veçantë e PSRK-së**

5.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit, dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

- a) kryerjen e akteve të terrorizmit (neni 110, KPPK),
- b) moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale (neni 303, KPPK), moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryerësit të saj (neni 304, KPPK) dhe dhënia e ndihmës kryerësve (neni 305, KPPK) kur këto vepra kryhen në lidhje me terrorizmin (ndihma në kryerjen e veprave terroriste - neni 111, KPPK);
- c) lehtësimi i kryerjes së terrorizimit (neni 112, KPPK), organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste (neni 113, KPPK)
- d) gjenocidi (neni 116, KPPK);
- e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);
- f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);
- g) sulmet në konfliktet e armatosura të një karakteri jo ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forcë të rrezikshme (neni 122, KPPK);
- h) rekrutimi dhe regjistrimi i personave midis moshës pesëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeçare në konfliktin e armatosur (neni 123, KPPK);
- i) përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit (neni 124, KPPK);
- j) organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës (neni 128, KPPK);
- k) rrezikimi i personave në mbrojtje ndërkombëtare (neni 141, KPPK);
- l) përvetësimi i paligjshëm, shfrytëzimi, bartja dhe vendosja e materialeve nukleare (neni 144, KPPK);
- m) kërcënimi për përdorimin ose kryerjen e vjedhjes apo plaçkitjes së materialit nuklear (neni 145, KPPK);
- n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);
- o) veprat penale të paraqitura në nenin 10 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale.

**IV. ANKESAT**

10. Ankuesi pohon se i është nënshtruar trajtimit poshtërues nga nëna dhe kolegët e vet të punës, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës

Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa).

11. Ajo më tej ankohet për shkelje të nenit 6 të Konventës (e drejta për gjykim të drejtë) dhe pohon se rasti i saj i dhunës në familje nuk është shqyrtuar nga gjykatat për tre vjet e gjysmë.
12. Ankuesi gjithashtu i referohet nenit 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë) dhe nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës. Ajo pohon se është përndjekur nga kolegët e saj për shkak të pikëpamjeve të saj politike. Më tej ajo pohon se iu është mohuar qasja në informata lidhur me prejardhjen prindërore të saj.
13. Së fundi, ankuesi i referohet nenit 14 të Konventës (ndalimin e diskriminimit) dhe pretendon se është diskriminuar nga kolegët e saj të punës, si dhe nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore, për shkak të pikëpamjeve të saj fetare dhe politike.

#### IV. LIGJI

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
16. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
17. Paneli tashmë ka konstatuar në shumë raste se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të marra brenda kontekstit të hetimeve penale ishin pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye kanë hyrë në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull, *B.Y. kundër EULEX-it*, 2014-06, 27 maj 2014, paragrafi 12, *I. kundër EULEX-it*, 2013-01, 27 nëntor 2013, paragrafi 12, *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, paragrafi 20-22; *Z. kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013, paragrafi 32; *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012, paragrafi 21). Prandaj, Paneli është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë.

18. Paneli thekson se në këtë lëndë, autoritetet e ndjekjes së EULEX-it kanë shqyrtuar parashtrirat e ankuesit në disa raste dhe kanë vendosur të mos e hetojnë lëndën pasi që ajo kishte dalë jashtë juridiksionit të tyre.
19. Duke shqyrtuar me kujdes dosjen e kësaj lënde, Paneli konstaton se rasti i ankuesit, në lidhje me abuzimin në familje dhe ngacmimet në vendin e punës, qartazi nuk hyn në kuadër të çështjeve që në atë kohë mund të ishin marrë përsipër nga prokurorët e EULEX-it në bazë të nenit 7 të Ligjit mbi Kompetencat (shih Kapitullin II, Ligji përkatës në fuqi). Paneli më tej nuk mund të konkludojë në bazë të informacionit në dispozicion që veprat penale të pretenduara bien nën autoritetin e prokurorëve të EULEX-it sipas Ligjit mbi Kompetencat. Prandaj dhe duke u bazuar në atë që u tha më sipër, Paneli nuk mund të konkludojë se prokurorët e EULEX-it kanë vepruar në mënyrë arbitrare atëherë kur kishin refuzuar të konsideronin kërkesat e ankuesit.
20. Paneli vëren që prokurorët e EULEX-it kanë këshilluar ankuesin për mundësinë e paraqitjes së një ankese kundër kryerësve të supozuar tek autoriteteve kompetente vendore dhe ka rekomanduar që ajo të kërkojë këshillë juridike. Kështu ajo është informuar lidhur me mjetet juridike në dispozicion në mënyrë që t'i ofrohej mbrojtja e të drejtave të saj.
21. Për më tepër, Paneli vëren se sjellja për të cilën është bërë ankesë duket se bie jashtë afatit gjashtëmujor, ku brenda këtij afati duhet të paraqitet ankesa në Panel, sipas rregullit 25(3) të rregullores së punës së Panelit (shih, p.sh. *Axhemi Zyhdi kundër EULEX-it*, 2016-05, 17 tetor 2017, par. 14-16, *Syla kundër EULEX*, 2015-10, 1 mars 2016, par. 16). Kjo ankesë është paraqitur në Panel më 13 mars 2017, ndërsa letra e fundit nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it është dërguar më 27 janar 2015. Nuk ka ndonjë indikacion për ndonjë përfshirje të EULEX-it pas kësaj date.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se ankesa është e pabazuar në bazë të nenit 29 (e) të Rregullores së Punës dhe se ajo nuk i përmbahet nenit 25(3) të Rregullores lidhur me afatin për paraqitjen e ankesës, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese